



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.302/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj Kryesues Kymete Kicaj, dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor-posterit në hapësirat publike në Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me 04.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.302/2025 e datës 01.02.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 01.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë A.nr.302/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendon se Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Skenderaj ka identifikuar posterin e vendosur në hapësirat publike, konkretisht në hyrje e sheshit të Skenderajt në hapësirën e dedikuar për gjelbërim, të kandidatëve për deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës PDK, Ariana Shoshi Musliu, Ganimete Musliu, dhe Bedri Hamza dhe më të njëjtin veprim subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, PDK, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: *"1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë. Andaj kërkohet nga PZAP-i, që duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lart cekura, që masa e sanksionit të vendoset sipas legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), thekson se pretendimet e Lëvizjes Vetëvendosje në ankesën A.nr. 302/2025, se Subjekti Politik PDK dhe disa prej kandidatëve për deputet me rastin e vendosjes së materialeve reklamuese - posterave kanë shkelur nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme konsiderojmë se nuk qëndron ligjërisht. Sipas përgjigjes në ankesë theksohet se me datë 21 janar 2025, N.SH."Foto Kabashi" ka marr pëlqimin nga Komuna e Skenderajt për të gjitha rastet e vendosjes së këtyre materialeve – posterve, reklamave, në shtyllat e ndriçimit publik, vendosjen e shpalljeve dhe publikimeve të përkohshme në muret e objekteve private dhe objekteve tejera në afat kohor njëvjeçar me numër të protokollit 09-334/01-0002929/25 e vulosur dhe nënshkruar drejtori përkatës. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksohet se për kandidaten Ariana Musliu Shoshi, ekziston pëlqimi dhe kontrata për shfrytëzimin e hapësirë në "Sheshin Adem Jashari" dhe se posterin e njëjta e ka vendosur pas marrjes së pëlqimit rrjedhimisht e njëjta është vendosur pas përpilimit të kontratës me numër protokollit 08/2025, të datës 22 janar 2025. Me tutje në përgjigje në ankesë pretendohet se për kandidaten Ganimete Musliu, në të cilin poster gjendet e vendosur edhe fotografia e kandidatit për Kryeministër Bedri Hamza, ekziston pëlqimi dhe kontrata për shfrytëzimin e hapësirë në "Sheshin Adem Jashari" dhe se posterin e njëjta e ka vendosur pas marrjes së pëlqimit rrjedhimisht e njëjta është vendosur pas përpilimit të kontratës me numër protokollit Nr. 07/2025 të datës 24 janar 2025. Poashtu theksojmë se kandidatet për deputete Ariana Musliu Shoshi dhe Ganimete Musliu, kanë ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për shfrytëzimin e këtyre hapësirave përkatëse, andaj kandidatet në fjalë me veprimet e tyre, nuk kanë bërë shkelje të nenit 34, par 1, nënparagrafi 1,2 të Ligjit nr.08/L-288 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe se nuk është kryer asnjë shkelje e përcaktuara në Rregulloren Zgjedhore nr.07/2024, për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Reklamimin Financiar si dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Përgjigjes në ankesë si provë i kanë bashkangjitur Pëlqimi i Komunës së Skenderajt për Kompaninë N.SH. "Foto Kabashi", Kontrata me numër Nr.prot.08/2025, e datës 22 janar 2025, si dhe Kontrata me Nr. prot. 07/2025, e datës 24 janar 2025

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se ankesa është e pa bazuar.

- Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik PDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se "*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat*

ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, fotot e bashkangjitura, pëlqimin nga Komuna e Skenderajt si dhe kontrata për shfrytëzimin e hapsirave reklamuese e lidhur ndërmjet pronarit dhe shfrytëzuesit, vërtetoi se vendosja e posterit nga kandidatit për deputet nga radhët e Subjekti Politik PDK, është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, neni 5. Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht nën paragrafi 1.2 *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo ne hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.302/2025 më datën 04.02.2025

Kryesuesi i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.